



BASHKIA  
TIRANË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE**  
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_, 2021

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

**Datë:** 04.03.2021

**Nga:** Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Tiranë

**Për:** Operatorin ekonomik: “Atom” sh.p.k me NIPT L22203042N

**Adresa:** Njësia Bashkiake Nr.10, Rruga “Islam Alla”, Pallati Nr.56, Kati i 1-rë, Tiranë

**Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-85834-02-03-2021**

**Procedura e prokurimit:** Kërkesë për propozime

**Objekti i Prokurimit:** Blerje pajisje kompjuterike

**Fondi Limit:** **2 500 000** (dy milion e pesëqind mijë) Lekë pa TVSH

**Burimi i Financimit:** Buxheti i Bashkisë Tiranë

**Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:** 10(dhjetë) ditë pas nënshkrimit.

**Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:** 15.02.2021

Ora: 09:00

**Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:** 15.02.2021 Ora: 09:00

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “**Atom**” sh.p.k me NIPT **L22203042N** me ofertë ekonomike me vlerë **2 463 000** (dy milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tre mijë) **Lekë pa Tvsh.**
2. Operatori ekonomik “**BNT Electronics**” sh.p.k me NIPT **J61817047D** me ofertë ekonomike me vlerë **2 099 700** (dy milion e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) **Lekë pa Tvsh.**
3. Operatori ekonomik “**Novotek**” sh.p.k me NIPT **L82031014K** me ofertë ekonomike me vlerë **2 499 500** (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) **Lekë pa Tvsh.**
4. Operatori Ekonomik “**PC Store**” sh.p.k me NIPT **L01606034A** me ofertë ekonomike me vlerë **1 919 800** (një milion e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind) **Lekë pa Tvsh.**

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “**BNT Electronics**” sh.p.k me NIPT **J61817047D** me ofertë ekonomike me vlerë **2 099 700** (dy milion e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) **Lekë pa Tvsh.**
2. Operatori ekonomik “**Novotek**” sh.p.k me NIPT **L82031014K** me ofertë ekonomike me vlerë **2 499 500** (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) **Lekë pa Tvsh.**
3. Operatori Ekonomik “**PC Store**” sh.p.k me NIPT **L01606034A** me ofertë ekonomike me vlerë **1 919 800** (një milion e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind) **Lekë pa Tvsh.**

Për arësyet e mëposhtme:

1) Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k me NIPT J61817047D me ofertë ekonomike me vlerë 2 099 700 (dy milion e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) Lekë pa Tvsh, u konstatua se:

*Operatori ekonomik ofertues nuk plotëson Shtojcën Nr.9, specifikimet teknike për produktin Nr.3 të Shtojcës 10, produkti i ofruar RB4011iGS+5HacQ2HnD-IN nuk plotëson specifikimet teknike pasi routeri i ofruar nuk disponon SIM Card. Gjithashtu routeri i ofruar nuk është Rack Mount. Institucioni ynë ka zgjedhur për një ruter të këtij kalibri për arsye se kërkohet një pajisje cilësore e cila ofron garanci dhe siguri në transmetimin e të dhenave dhe rrjetit WiFi. Kjo pajisje kërkohet të ketë manaxhim në distance dhe të ketë porte SFP për komunikim me fiber optike në distanca të largëta ndërmjet kateve dhe seksioneve të godinave ku do të implementohet ky rrjet WiFi. Gjithashtu është zgjedhur që pajisja të ofrojë backup interneti me anë të kartave SIM që vendosen në pajisje në rast se mungon interneti nga burimi primar. Pajisja kërkohet të jete e tipit industrial dhe ristartim në distance pa qene nevoja të shkohet fizikisht tek vendi i montimit. Kërkohet të jete pajisje metalike, industriale dhe e montueshme në Rack ose në module tavanore pasi do të percaktohet pozicionimi i saj. Rrezja e veprimtimit dhe e transmetimit duhet të ketë një standart të lartë në mënyrë që me sa më pak pajisje të menaxhohet e gjithë godina.*

2) Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Novotek” sh.p.k me NIPT L82031014K me ofertë ekonomike me vlerë 2 499 500 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) Lekë pa Tvsh, u konstatua se:

- *Operatori ekonomik ofertues nuk plotëson pikën 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar.*
- *Operatori ekonomik ofertues nuk plotëson të gjithë pikën 2.3 Kapaciteti teknik, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion.*

3) Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “PC Store” sh.p.k me NIPT L01606034A me ofertë ekonomike me vlerë 1 919 800 (një milion e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind) Lekë pa Tvsh, u konstatua se:

- *Operatori ekonomik ofertues nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk përmbushet pika dh), dokumentacioni i paraqitur, vërtetimi i FSHU është i parregullt, pasi është i pafirmosur dhe i pavulosur.*
- *Operatori ekonomik ofertues nuk plotëson Shtojcën Nr.9, specifikimet teknike për monitorin janë kërkuar jo më pak se 23’’, ndërsa nga ofertuesi është ofruar monitor 21.5’’.*
- *Operatori ekonomik ofertues nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar për produktin Nr.3 të Shtojcës 10, “Router Wireless Professional”.*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**ATOM**” sh.p.k me NIPT L22203042N me adresë: Njësia Bashkiake Nr.10, Rruga Islam Alla, Pallati Nr.56, Kati i 1, Tiranë, me ofertën ekonomike me vlerë **2 463 000** (dy milion e katëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë) Lekë pa Tvsh, e paraqitur për tenderin me objekt; “**Blerje pajisje kompjuterike**”, REF-85834-02-03-2021, me afat të lëvrimin deri 10 (dhjetë) ditë pas nënshkrimit, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, Tiranë, Rruga “5 Maji”, Godina 17, Tiranë**, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së njoftimit për lidhjen e kontratës nga AK.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, Autoriteti Kontraktor do të anulohet procedurën e prokurimit në zbatim të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimet publike”.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë më datë 19/02/2021.**

**Ankesa:** Nuk ka pasur.

**TITULLARI AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Erindi Bejko**